

Thyamis



ALB

"...në aspektin gjuhësor, shumë studimes dhe gjuhëtarë, duke përfshirë edhe Eqerem Çabej, prejardhjen e emrit Çamëri, e lidhin ngushtë me emrin e lumit Thyamis që njihet si territor shqiptar, gjë që provon autoktoninë e kësaj krahine."

Nr. 6 • Dhjetor 2013

www.cameriainstitute.org


Buletin i Institutit të Studimeve për Çamërinë



Luan Malltezi : "Çështja kryesore për Mid'hat Frashërin ishte çështja çame"



JASIN SADIKU



INSTITUTI I STUDIMEVE PËR ÇAMËRINË
INSTITUTE OF CHAM STUDIES



Aktivitetet e vitit



Këtë buletin kemi vendosur ta emërtojmë “*Thyamis*” për shkak të lidhjes së ngushtë të emrit Çamëri me emrin e lumit që e përshkon atë, *Thyamis*-in antik. Për prejardhjen e emrit Çamëri, trajtesat më të hershme u takojnë studiuesve të huaj, si W.M.Leake, Pouqueville, etj, të cilët janë përqendruar tek toponimia. Gjuhëtari shqiptar Egerem Çabej, mbështet të njëjtën tezë duke vërejtur vazhdimësinë e dy termave nga *Thyamis* në *çam*, që shpjegohet nëpërmjet ligjësive fonetike të shqipes: Pjesa e parë (- *thy*) e kompozitës (-*thyamis*), rrjedh nga folja shqipe -*thyej*, ndërsa pjesa e dytë (-*am*), nga emri shqip ilirisht -*amë*, *ama*, *ëma*, në kuptimin *amtar*, e cila si formë fjalëformuese (*thy+am=thyam*), shkon në përfundim logjik të shprehjes shqipe, *ama e thyer*, me kuptimin e *thyerjes së amës pellazgjike illire*. Mendohet se etimologjia shqipe e emrit të hidronomit *Thyamis*, linguistikisht, lidhet me formën tjetër të shqipes, ku nga “*thy amë*”, u krijua forma sinonimike *ça amë* që i përgjigjet folja shqipe *çaj* (*çarja e amës-ëmës*). Në këtë mënyrë, sipas mbështetësve të kësaj teze, është krijuar forma shqipe -*ça am(ë)*, (*u*) *ça ama*, ku me rënien e njëres zanore -*a*, formohet emërtimi *çamë* (*ça+amë*). Në trajtën e pashquar, emrit i shtohet prapashtesa -*ri*, duke formuar toponimin *Çamëri* (*ça+amë+ri*).

Stafi i buletinit:

Drejtoi :

Kaltra Bardhi dhe Ines Dako

Redaktoi në shqip :

Kaltra Bardhi

Grafika :

Alfred Nikolla

Një falenderim i veçantë për :

Prof. Luan Malltezi

Prof. Enver Kushi

Botues :

Instituti i Studimeve për Çamërinë
(ISÇ)

Drejtore i Institutit të Studimeve për Çamërinë:

Gjergj Xhafa

Instituti i Studimeve për Çamërinë (ISÇ) është një organ jo-fitimprurës. U themelua në maj të vitit 2004 në Tiranë, me iniciativën e një grupi prej 17 intelektualësh të fushave të ndryshme, si të shkencave politike, juridike, historike, sociologjike, të marrëdhënieve ndërkombëtare etj. ISÇ është regjistruar dhe funksionon në bazë të statutit dhe rregullores së vet, në harmoni me ligjet e shtetit shqiptar dhe të drejtës ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij newsletter-i është të bëjë të mundur shpalosjen në masë të gjerë të historisë së Çamërisë, etnografisë, etnolinguistikës, dokeve, zakoneve dhe kulturës së bukur të krahinës së Çamërisë. Nëse i gjithë komuniteti çam kërkon një zgjidhje të kënaqshme, hapi i parë është sigurisht kthimi pas në të kaluarën, për të kujtuar gjithmonë historinë dhe arsyen që kërkojmë drejtësi. Synimi i newsletter-it tonë është të tregojë vlerat që populli çam ka patur dhe vazhdon të ketë, për t'i trashëguar ato edhe tek brezat e rinj, nëpërmjet kulturës dhe dialektit që e karakterizon.

Për këtë arsye, Instituti i Studimeve për Çamërinë me botimin e këtij newsletter-i ka për synim që nëpërmjet aktiviteteve të shumëllojshme dhe me tematikat e ndryshme që trajton, të ndërgjegjësojë masën për vlerat e këtij komuniteti.

Historiku

Si u trajtua çështja çame pas genocidit

fq 3 - 4

Qytetet

Këto troje na përkasin!

Janina

fq 5

Analizë kulturore

Enver Kushi: Mid'hat Frashëri dhe çështja çame

fq 6-7

Intervistë

Luan Malltezi: “Çështja kryesore për Mid'hat Frashërin ishte çështja çame”

fq 8-9

Personalitet

Jasin Sadiku

fq 10-11

Botime

Kombi gjen vetveten, Çamëria dhe Kosova

fq 12

Aktivitetet:

Aktivitetet e vitit

fq 13-14

Poezi

fq 15

SI U TRAJTUA ÇËSHTJA ÇAME PAS GJENOCIDIT

Më 27 qershor të vitit 1944, në krahinën e Çamërisë, ndaj popullatës shqiptare myslimane, filloi akti i fundit i gjenocidit, që çoi në spastrimin etnik të kësaj popullate martire. Bandat kriminale të shovinizmit grek derdhën mbi këtë krahinë mizoritë më të pashembullta të njerëzimit. U shkatërruan të gjitha objektet e kultit. U grabitën pasuritë dhe pronat e këtyre kulteve (mbi 80 xhami). Përmasat e kësaj tragjedie dhe qëllimin e saj e dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme edhe misionet anglo-amerikane, që vepronin në këtë kohë në Greqi dhe në Shqipëri. Terrori ishte i përmasave të tilla, sa që popullsia shqiptare myslimane u detyrua të braktisë trojet e të parëve të tyre mijëravjeçare, duke gjetur strehë në Republikën e Shqipërisë.

Numri i popullsisë së dëbuar nga Çamëria ka variuar nga 23 mijë deri në 44 mijë vetë. Sipas të dhënave të OKB-së, kjo popullsi është 26 mijë vetë. Autorë të ndryshëm japin shifra të ndryshme, pjesa më e madhe e të cilëve jep shifrën 35.000 qytetarë. Në kalvarin biblik të shpërnguljes së dhunshme të popullsisë çame, mohimi i të drejtës së ligjshme për rikthim në trojet autoktone (njohja e pasurisë) vazhdon të mbetet një problem madhor edhe pas më shumë se 6 dekadash. Në këtë kuadër, referuar dokumenteve arkivore, konstatohet se

përpyjekjet serioze të shtetit shqiptar në mbrojtje të problemit çam nisin menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Veçanërisht, periudha 1945-1948, sipas dokumenteve zyrtare të kohës, është një periudhë që karakterizohet nga përpjekjet e vazhdueshme të shtetit të ri shqiptar për problemin e Çamërisë. Kështu, mes të tjerave, me interesimin dhe porosinë e drejtuesve të kohës së



shtetit shqiptar, në gusht të vitit 1945, është dhënë urdhëri për hartimin e një libri të veçantë për problemin çam, me synim sensibilizimin e opinionit ndërkombëtar për tragjedinë e një populli të pambrojtur. Kështu, në gusht të vitit 1945, në zyrat e Drejtorisë së Shtypit dhe të Propagandës, u thirr Musa Demi, të cilit iu kërkua përgatitja e librit nga Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Ky i fundit hartoi një plan tematik të detajuar, për mënyrën se si do të grumbulloheshin materialet, kriteret bazë për

përzgjedhjen e tyre, etj. Libri, me titullin “Actes agressifs du gouvernement monarcho-fasciste Grece contre L’Albanie”, më në fund u botua në vitin 1947. Më pas, u krijua Komiteti Nacionalist Çlirimtar Çam, i cili kishte si synim të shkonte në Çamëri dhe të luftonte kundër forcave të djathta të EDES-it sepse vetëm në këtë formë ata do të mund të riktheheshin në vendin e tyre. Kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1949, kur fronti i majtë u thye. Në vitet në vijim, situata kundrejt popullsisë çame filloi të ndryshonte. Ndaj komunitetit të ardhur nga Çamëria nisi fryma diskriminuese, e cila ishte ushqyer nga segmente pro greke, që gjeneronin mendësi dhe praktika për diktaturën dhe vetë diktatorin. Ishte një sistem i ngritur në antivlerën si shprehje e luftës së klasave dhe brenda llojit për sundim dhe krijimin e situatave të ndera edhe brenda këtyre komuniteteve. Çamët, këtë e kanë provuar më së miri pas 28 korrikut të vitit 1960, kur u arrestuan në zyrat e tyre apo në vendet e punës krerët më të lartë të të ashtuquajturit “grupi i çamëve”. Teme Sejko, në pozicionin e Ministrit të Mbrojtjes, Tahir Demi në Komitetin Ekzekutiv, Taho Sejko në zyrën e tij në Shkodër, Shaban Ademi po në zyrën e tij në Elbasan e kështu me radhë të gjithë viktimat e çmenëdurisë së diktatorit. Brenda vitit, një

pjesë e elitës, të ashtuquajturit “grupi i çamëve” u ekzekutuan me ose pa gjyq. Pikërisht këtu filloi fatkeqësia për të gjithë komunitetin. Jo vetëm vrasjet e tyre të padrejta kundrejt tyre, por futja në masë e frymës antiçame, me ose pa dashje, u bë pjesë e zakonshme e jetës shqiptare. Kështu, vijoi ndaj popullsisë çame një proces goditjeje politike dhe persekutimi politik. Qeveria e asaj kohe donte ta mbyllte çështjen çame me dhënien e shtetësisë së detyrueshme shqiptare, ndërkohë që me grekët e kishte mbyllur tërësisht diskutimin. Çamët e dëbuar nga pronat e tyre kishin qenë të pajisur me pasaporta greke. Në Shqipëri ua morën pasaportat dhe u dhanë menjëherë shtetësinë shqiptare, duke ua bërë të pavlefshme pasaportat e vjetra. Regjimi i kohës mori masa të rrepta që çamët të mos protestonin. Kthimi i tyre nuk u lejua, duke nxjerrë në pah dyshime se regjimi ishte i përzier në këtë proces. Kështu, pas kalvarit të vuajtjeve nga masakrat e bandave të Napoleon Zervës, diskriminimi nga shteti amë, tek i cili kërkuan shpëtim, e lëndoi më shumë këtë popullsi. Gjatë kësaj periudhe, kjo temë delikate për të arritur zgjidhjen e çështjes çame nuk u prek më, por përmendej vetëm në formë presioni nga Enver Hoxha, atëherë kur Greqia pretendonte më shumë pjesë të territorit shqiptar. Problemin çam, shteti shqiptar e trajtoi

vetëm në kornizat e ideologjisë. Deri në vitin 1971, mes dy vendeve nuk kishte marrëdhënie diplomatike. Në shkolla nuk flitej për këtë çështje dhe kjo po mbetej thjesht si kujtim i çamëve të vuajtur. Në mënyrë të qëllimshme u hesht për tragjedinë çame dhe fatkeqësinë e saj. Enver Hoxha nuk donte ta acaronte Greqinë, sepse kishte dëshirë të kishte marrëdhënie sa më të qeta me të, për arsye të dobësisë



së tij brenda vendit dhe të izolimit ndërkombëtar. Kështu, të gjitha këto arsye bënë që nga regjimi i kohës të heshte ndaj çështjes çame. Kjo heshtje, për arsye politike, u pasqyrua edhe në tekstet shkollore, ku Çamëria dhe çështja çame nuk përmendej askund.

Si çështje politike, ky problem është ngritur për herë të parë në një takim të nivelit të lartë, ndërmjet kryeministri grek Micotaqis dhe Ramiz Alisë në vitin 1991, por ish-presidenti Alia ndeshi vetëm në reagimin negativ të Micotaqis, i cili

në atë kohë u shpreh se “nuk ekziston asnjë problem çam”. Përpjekje janë bërë edhe në vitin 1991 me krijimin e Shoqatës Patriotike Çamëria, e cila ka organizuar një sërë takimesh në ambasadat e huaja të akredituara në Tiranë përfshirë dhe atë greke, si edhe ka zhvilluar aktivitete për sensibilizimin e opinionit vendas dhe atij ndërkombëtar për njohjen e tragjedisë së ndodhur me popullsinë çame. Nismëtarët e

kësaj shoqate kanë qenë Abaz Dojaka, Arshin Rexha, Hasan Minga, Sali Bollati, Petrit Demi, Lutfi e Hilmi Sake, Petrit e Hilmi Kasemi, Ferhat e Emin Sejko, Resul Taipi etj.

Janina

Janina është një nga qytetet më të mëdha të Epirit. Sipas historianëve ajo u themelua gjatë sundimit të Justinianit (shek. VI). Ajo shtrihet në veriperendim të liqenit Pamvotida dhe është njohur si qyteti më i rëndësishëm i Bizantit. Në vitin 1430, Janina iu dorëzua paqësisht perandorisë osmane. Në vitin 1611 Dionisi dhe ish-peshkopi i Lar-

isës udhëhoqën në të gjithë rajonin një kryengritje të gjerë kundër perandorisë osmane. Kryengritja u shtyp nga komandanti i Janinës, Asllan Pasha. Konkluzioni i kësaj kryengritjeje ishte heqja e privilegjeve të qytetit. Kisha e Shën Gjon Pagëzuesit u shkatërrua dhe u shndërrua në një xhami, të quajtur

Xhamia e Asllan Pashës. Kjo xhami, e ndërtuar në vitin 1618 (sot muze në kështjellë), i ishte kushtuar



Asllan Pashës, i cili kishte shtypur kryengritjen e Dionisit. Populli i shpronësuar i qytetit, themeloi për herë të parë, vendbanime të reja jashtë kështjellës. Gjithashtu, xhamia e Fetihut dhe ajo e Asllan Pashës (e cila sot është muze i etnografisë) janë gjetur në këtë vend. Sipas statistikave të perandorisë

osmane, Janina kishte një popullsi prej 40.000 myslimanë shqiptarë dhe 30.000 grekë dhe shqiptarë ortodoks.

Në juglindje të Janinës ndodhet një nga vendet më mbresëlënëse të antikitetit, tempulli i Dodonës, i cili është ngritur për nder të Zeusit dhe gruas së tij. Gjurmë të rëndësishme në arkitekturë ka lënë edhe periodha e Ali Pashë Tepelenës. Kështjellat, xhamitë

si edhe ndërtesat shtetërore, janë



ndërtuar në shekullin e XVIII. Rrugicat e ngushta dhe shtëpitë në qytetin e vjetër, pasqyrojnë më së miri zhvillimin e Janinës së atij shekulli. Sot, gjenden muzeume të ndryshme arkeologjike dhe folklorike, si edhe ekspozita me artefakte argjendi që i përkisnin thesarit të Ali Pashë Tepelenës.



MID'HAT FRASHËRI DHE ÇËSHTJA ÇAME

Libri “Mid’hat Frashëri, ministër fuqiplotë. Athinë (1923-1926)”. Çështja çame”, i përgatitur nga Prof. Luan Malltezi dhe Prof. Sherif Delvina, sheh dritën e botimit, falë bujarisë së biznesmenes çame Zhaneta Salii. Ky libër na rikthen ditët, javët, muajt dhe vitet e Mid’hat Frashërit në Athinë, duke ndjerë dhe prekur përkushtimin e tij për Çamërinë dhe popullsinë e saj martire, përkushtimin e një fisniku dhe idealisti të klasit të parë, por jo vetëm kaq. Gjatë leximit dhe rileximit të këtij libri (sepse u jam rikthyer disa herë kronikave tron-ditëse të tij), në çdo fjalë, frazë, mendim kam dëgjuar edhe zërin e Mid’hat Frashërit, herë - herë të qetë dhe të përmbajtur, herë - herë të shqetësuar, të menduar, të trazuar dhe herë - herë zemërak apo të indinjuar. Në këtë libër, Mid’hat Frashëri del përfaqësues i denjë i një vendi vërtet të vogël, por aspak inferior, përkundrazi. Figura dhe personaliteti i tij është imponues në takimet dhe bisedat në zyra dhe me zyrtarët më të lartë të qeverisë greke që nga presidenti, kryeministri, Ministri i Jashtëm dhe deri te zyrtarët burokratë të rangut të dytë. Duket që qeveria shqiptare kishte bërë një zgjedhje të mençur dhe të përshtatshme në kohën dhe vendin e duhur. Nuk ishte rastësi që një personalitet si Mid’hat Frashëri, të

linite papritur detyrën si i Dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë në Uashington, pra në një nga vendet që kishte mbrojtur si askush tjetër në Konferencën e Paqes të Parisit, Shqipërinë e vogël dhe me shumë, shumë pak miq. Ai i duhej Shqipërisë në Greqi, si i dërguari i posaçëm i vendit të tij, sepse nuk kishte të dytë si ai që do të mbronte popullsinë shqiptare që jetonte në trojet e veta etnike në Çamëri dhe në viset e tjera si Kostur, Konicë, Follorinë etj. Nuk kishte të dytë si ai, që falë kulturës së gjerë, njohjes së gjuhës dhe kulturës greke, do të çonte mesazhe miqësie dhe bashkëpunimi me Greqinë dhe popullin grek.

Nëse lexon me vëmendje kronikën e parë, kupton qartë misionin sa të vështirë, aq edhe fisnik të Mid’hat Frashërit në Greqi. Kjo ndihet në bisedën me Ministrin e Jashtëm Aleksandër, por edhe në të dhëna të tjera: “ai është 45 vjeç. I ati i tij qenka shqiptar nga Llaka i Sulit.” Më tej, vihen në dukje të dhëna për takimin me mbretin Gjergj II: “është 33 vjeç dhe i ngjan shumë t’et. Duket me shëndet të mirë, buzëqesh... bën shumë pyetje, pak si i rrëmbyer në të pyetur, por i paduruar në të dëgjuar, shëtit në qytet dhe në rrethinat, që të duket...” Jepet gjithashtu edhe një detaj tjetër: “mbreti donte të mësonte shqip, meqenëse ka lindur

në një fshat, ku fshatrat rreth tij flasin arbërisht. Pra, edhe mbreti i Greqisë,” shkruan Mid’hat Frashëri, “veten e tij e shikon gjysmë shqiptar...” Ai drekon me një tjetër zyrtar të lartë, kolonel Dimitër Boçari, gjithashtu shqiptar nga Suli dhe fisi i famshëm i Marko Boçar Çamëria, siç thuhet në një varg të këngës popullore çame... Në kronika të tjera, gati dy vjet pas emërimit të tij si ambasador, në krye të qeverisë greke do të vinin dy arvanitas: “i pari Pangallos, kryeministër dhe i dyti Rufos, Ministër i Jashtëm, që në shkurt të vitit 1926, do të bënim ca deklarata nga më surprizueset për marrëdhëniet shqiptaro - greke dhe trajtimin e shqiptarëve të Çamërisë.” Ai shkruante me simpati për takimin me presidentin grek, admiralin Kondurioti: “Admiral Kondurioti,” informon ai nga Athina më 2 korrik 1924, “mburret që është shqiptar dhe regreton që arbëreshët e Greqisë po e harrojnë ca nga ca gjuhën e tyre”. Por më 21 nëntor të vitit 1925 në “Të dhëna për kolonel Aleksandër Konduli i emëruar ministër fuqiplotë i Greqisë në Shqipëri”, nuk e fsheh entuziazmin për këtë emërim, si edhe vlerësimet për këtë personalitet grek me origjinë shqiptare. “Zoti Konduli,” shkruan Frashëri, ka një interes dhe simpati të madhe për Shqipërinë. Zoti Konduli i shikon silloget vorio

Analizë kulturore

- epirotë si qendra intrigash dhe vjedhjesh, të rrezikshme për Greqinë, si edhe për Shqipërinë. Shqiptari s'bëhet grek, thotë, as greku shqiptar. Pra të heqim dorë nga një politikë me gënjeshtër".

Sa më lart, a do të ndikonin këta për një klimë më të ngrohtë mes Shqipërisë dhe Greqisë dhe veçanërisht për minoritetin çam të Epirit apo për shqiptarët që jetonin me shumicë në Kostur, Follorina, Konicë dhe rrethina? A është rastësi që herë pas here në njoftime që ai i dërgon Tiranës zyrtare, jep të dhëna për origjinën shqiptare të qeveritarëve të lartë në piramidën shtetërore greke, deri edhe detaje të tilla si: "Po, që tri javë, jemi pjekur gjashtë herë bashkë (pra me Kondulin) kemi ngrënë drekë, kemi marrë çaj, bëmë edhe një ekskursion në Pire, në shoqëri të gjeneralit Pargallos dhe të gjithë fëmijësë, ku vizituam një fabrikë për qelqe..." Është një temë që duhet diskutuar dhe që duhet trajtuar më gjatë. Megjithatë, përtej ndonjë momenti vlerësimi entuziast për ndonjë syresh, siç është Konduli, Mid'hat Frashëri është i ftohtë në gjykimet e tij për rolin dhe rëndësinë e këtij faktori, për ndikimin e këtyre qeveritarëve grekë me origjinë shqiptare, për dëbimet masive të popullsisë së krahinës së Çamërisë, Kosturit, Konicës dhe Follorinës nga trojet e tyre, për ndalimin e krimin ndaj tyre apo për njohjen e minoritetit shqiptar në Greqi dhe dhënien e të gjitha të drejtave të tyre, sipas Traktatit të Sevres të 10 gushtit 1920, që Greqia e kishte nënshkruar.

Mid'hat Frashëri, çështjen çame nuk e bëri pre të kulisave të fshehta diplomatike apo kompro

miseve të dëmshme. Për të Çamëria dhe Epiri ishin të shenjta dhe nuk mund të heshte kur kjo shenjtëri, që lidhej me një truall nga më të begatët të kulturës së lashtë shqiptare, të zhbëhej nga disa "kokëndezur", siç është shprehur në vitin 1926 kryeministri grek Pangallos. Në këtë libër, duket qartë që Mid'hat Frashëri, çështjen çame e trajtoi në një këndvështrim të gjerë, pra si çështje dhe problem në radhë të parë mes dy qeverive dhe më pas si problem ndërkombëtar. Si askush tjetër, ai e ngriti këtë çështje në forumet ndërkombëtare të kohës, siç ishte Lidhja e Kombeve. Misioni i tij në Athinë ishte i mundur, jo i pamundur, sepse Mid'hat Frashëri ishte dhe mbetet diplomati më i mirë. Për çështjen shqiptare dhe kryesisht për çështjen çame, gjatë tre viteve të qëndrimit në Athinë, ka bërë më shumë se të gjithë diplomatët shqiptarë gjatë këtyre 90 viteve. Pas tij, askush nuk e ka patur kurajon, idealizmin dhe ndershmërinë e tij. Nuk mund të ndodhte ndryshe, Mid'hat Frashëri kishte trashëguar shumë nga aureola e idealizmit të rilindasve tanë dhe veçanërisht të babait, Abdyl Frashërit, xhaxhait, engjëllit mbrojtës të shqiptarëve, Naim Frashërit, si edhe të hartuesit të programit për Shqipërinë e ardhshme, Sami Frashërit. Ai ishte dhe mbetet një nga njerëzit më të kulturuar, një enciklopedi e vërtetë. A mbeti vetëm misioni i pamundur dhe i porealizuar ai i Mid'hat Frashërit në Athinë apo përtej dëshirës së tij për të ndërtuar ura miqësie me Greqinë dhe për të mbrojtur nga zhbërja Çamërinë, misioni u ndërpre në mes? Largimi i tij nga Athina,

po të lexosh kronikat e fundit të këtij libri, ishte i detyruar. Ai nuk e donte këtë largim, sepse dukej sikur po braktiste një nga sfidat më të mëdha të jetës së tij: normalizimin e marrëdhënieve me Greqinë, por veçanërisht pamundësinë për të mbrojtur deri në fund shqiptarët e Çamërisë.

Profesor Luan Malltezi, në parathënien e këtij libri jep argumente bindëse për dorëheqjen e Mid'hat Frashërit. Ka qenë i trishtë dhe shoqëruar me nervozizëm largimi i tij nga kryeqyteti grek. Atje linte një pjesë të kohës së tij të çmuar, ditët dhe netët e paqeta, pritjet protokollare, shëtitje në kohë të lirë, orët e paqeta deri në dhimbje kur kishte dëgjuar rrëfimet e krerëve të parisë çame apo të tjerëve për grabitje pronash, rrahje, vrasje, presione për t'u deklaruar si turq e jo si shqiptar, pas Marrëveshjes së Lozanës, qëndrim deri pasmesnate për të hartuar njoftime dërguar eprorëve të tij në Tiranë...

Ky është një nga botimet më serioze që vjen në 100-vjetorin e Konferencës së Londrës dhe 90-vjetorin e caktimit të Mid'hat Frashërit si Ministër Fuqiplotë në Athinë. Është një libër zëfolës, tepër aktual edhe sot, ku çështja çame është shtruar për zgjidhje. Është një libër shkollë për diplomacinë shqiptare, sepse na duhet kultura dhe dinjiteti i Mid'hat Frashërit, forca argumentuese për mbrojtjen e çështjes çame, kurajoja e tij dhe shenjtërimi i kësaj çështjeje. Politikanët çamë duhet të mësojnë nga idealizmi i Mid'hat Frashërit. E përsëris, idealizmi dhe jo kompromiset. Idealizmi i kulluar dhe jo makutëria për karrige të përkohshme pushteti.

Luan Malltezi : “Çështja kryesore për Mid’hat Frashërin ishte çështja çame”



Z. Malltezi, mund të më flisni për eksperiencat tuaja profesionale, si njohës i mirë i fushës së historisë, menaxhues dhe drejtues i institucioneve të ndryshme kulturore?

Shkollën e lartë e kam vazhduar për histori. Pas përfundimit të saj, kam filluar të interesohem dhe të studioj për historinë e Mesjetës, në Institutin e Historisë. Kam punuar tek Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Në vitet 1993-1997 kam qenë drejtori i Arkivit të Shtetit dhe në krye të vitit 2009 jam emëruar Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar.

Sa të rëndësishme janë institucionet tona për evidentimin dhe zgjidhjen e çështjeve me rëndësi kombëtare?

Rëndësi të madhe për kombëtarizimin e këtyre çështjeve, siç është edhe çështja çame, është puna e realizuar nga Arkivi i Shtetit, Biblioteka Shqiptare, Instituti i Historisë dhe në përgjithësi i të gjithë institucioneve që bëjnë përmbledhje, hulumtime, nxjerrjen në pah të dokumentacioneve të ndryshme që janë fakte të padiskutueshme që shërbejnë për të arritur tek e vërteta.

Sëbashku me Prof. Sherif Delvinën, çfarë ju shtyu të bënit hulumtime për realizimin e librit “Mid’hat Frashëri, Ministër Fuqiplotë në Athinë (1923-1926). Çështja çame”?

Gjithmonë më ka interesuar çështja çame, për hir të problematikës që mbart, por, konkretizimi i interesimit duke më bërë të vendosur që të punoja duke mbledhur, analizuar dhe seleksionuar dokumentacione të faktuara për këtë çështje, ka nisur qysh kur kam punuar si drejtor i Arkivit Qendror të Shtetit, sëbashku me shtysën dhe ndihmesën e Znj. Kaliopi Naska, një studiuese e njohur e historisë shqiptare..

Sa e vështirë ka qenë analiza kërkimore dhe sa kohë është dashur për realizimin e një vepre të tillë cilësore?

Në këtë vepër ne i jemi referuar letërkëmbimeve të Mid’hat Frashërit me eprorët e tij në Shqipëri, si edhe takimeve në Athinë me diplomatë të huaj. Duhet marrë parasysh puna e madhe, si edhe një punë e realizuar me angazhim e durim, në pasurinë e madhe studimore ekzistuese në Arkivat Qendrore të Shtetit dhe Arkivat Angleze, për të nxjerrë një botim të suksesshëm dhe të dobishëm, siç është libri i realizuar nga unë dhe z. Sherif Delvina. Duke marrë parasysh vështirësitë kërkimore në dokumentacione, aspektin studimor dhe temën e

gjërë të kësaj çështjeje, mund të them se janë dashur rreth 6 vjet punë derisa të arrihej në botimin e librit “Mid’hat Frashëri, Ministër Fuqiplotë në Athinë (1923-1926). Çështja çame”.

Kush ishte Mid’hat Frashëri? Cili ishte kontributi i tij për Shqipërinë?

Mid’hat Frashëri është një nga kolosët e mendimit politik në Shqipëri. Është një figurë shumë e rëndësishme politike, i cili vjen nga shtëpia e madhe e Frashëllinjve. Ka filluar të përkthejë që në moshën 15-vjeçare, ka një veprimtari të jashtëzakonshme qysh nga 1897 deri në ‘43-shin në fushën e kulturës shqiptare, si publicist, albanolog, përkthyes, diplomat etj. Ai prezantonte veprat e albanologëve të mëdhenj. Kishte një formim të jashtëzakonshëm. Në vitin 1908 ka botuar gazetën “Iliria” dhe më pas gazetën “Dita”. Si veprimtar i çështjes kombëtare, në shoqërinë e paarsimuar të asaj kohe, ka kontribuar në çeljen e shkollave dhe shoqatave të ndryshme. Ai ishte një nga ideologët më të mëdhenj, madje problemet e Rilindjes diskutoheshin në shtëpinë e tij.

Mid’hat Frashëri ishte firmëtar i Aktit të Pavarësisë, intelektual, deputet, patriot, ministër. U zgjodh kryetar i Kongresit të Manastirit dhe nënkryetar i Komisionit të hartimit të alfabetit. Në qeverinë e Ismail Qemalit është zgjedhur ministër i Punëve të Përgjithshme. Në janar të vitit 1923 filloi detyrën

e Ministrisë Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Athinë, deri në dhjetor të vitit 1925. Shumë vepra të tij janë botuar në gjuhë të huaja, me qëllim që të ishin të vlefshme dhe të lexoheshin edhe nga Lidhja e Kombeve, Komiteti Evropian etj.

Cilat kanë qenë përpjekjet e tij për të arritur në një marrëveshje dhe zgjidhje të çështjes çame? Mendoni se përpjekjet e Mid'hat Frashërit për moszbatimin e ligjeve që i detyronin çamët të largoheshin, kanë qenë të mjaftueshme?

Çështja kryesore për të ishte çështja çame. Ai ka bërë maksimumin duke filluar nga çështja e shkëmbimit të popullsisë, por nga ana tjetër, edhe çështja çame i jep vlera Mid'hat Frashërit. Ai informonte Ministrinë e Jashtme që pala greke po dëbonte me dhunë çamët myslimanë si edhe që grekët kishin korrupsion dhe klerin mysliman, për të realizuar qëllimin e largimit të popullsisë në Turqi. Ministri shqiptar në Athinë kërkoi dhe realizoi takime të shumta me palën greke, ku kërkonte mospraktikimin e kësaj politike dhe respektimin e akteve dhe konventave ndërkombëtare për popullsinë shqiptare në Greqi, sikurse bënte shteti shqiptar me popullsinë greke në Shqipëri. Ai u përpoq të sensibilizonte edhe Lidhjen e Kombeve për ato që po

ndodhnin me popullsinë çame, por aty hasi me pafuqinë e kësaj të fundit për t'ju kundërvënë qeverisë greke. Pasi filloi ky diskriminim, Mid'hati kërkoi si rrjedhojë dëbimin e grekëve në Shqipëri. Gjithçka ai ia përcillte Tiranës zyrtare. Falë tij, Ministria e Jashtme Shqiptare, kishte një dosje të plotë të çështjes çame, për dëbimin me dhunë, plaçkitjet, përfshi këtu edhe lutjet dhe kërkesat e popullsisë myslimane drejtuar qeverisë greke. Megjithatë, dokumenti më i rëndë


kënaqshme.

Keni ndonjë botim tjetër në dorë? Cilat janë planet tuaja profesionale për të ardhmen?

Po, sëbashku me Sherif Delvinën, jemi duke punuar për të botuar librin “Udhëtarët e huaj në Shqipëri”. Duke patur parasysh kritikën e shumta dhe të vlefshme të Mid'hat Frashërit, kemi planifikuar botimin e disa prej këtyre kritikave historiko-geografike të tij. Planet e mia për botime shumë interesante kushtuara lexuesit shqiptar janë të shumta.

Tekstet tona aktuale, përfshi edhe tuajin, i cili ka ngjallur shumë interes tek lexuesit, mendojnë se e ndihmojnë zgjidhjen e çështjes çame?

Sigurisht që ndihmojnë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Libri në fjalë është botuar dhe punuar enkas për çështjen çame. Është bazuar në dokumentacione shumë të pasura dhe është më e rëndësishmja, të faktuara. Libri “Mid'hat Frashëri, Ministër Fuqplotë në Athinë (1923-1926). Çështja çame”, i realizuar edhe me ndihmën e çames Zhaneta Saliu dhe Institutit të Studimeve për Çamërinë, duhet lexuar medoemos, pasi ky është një angazhim i jashtëzakonshëm kombëtar.



sishëm është siguruar nga Arkivat Angleze ku janë gjetur të dhëna që Zogu ka kërkuar arsye që të përjashtonte Mid'hat Frashërin nga detyra dhe për herë të parë del në pah kompromisi i Zogut me grekët për largimin e Mid'hat Frashërit nga Greqia. Duke shtuar edhe shumë përpjekje të tjera dhe punën e palodhshme të tij, duhet thënë që Mid'hat Frashëri i ka kushtuar shumë çështjes çame dhe ka bërë të pamundurën për të arritur një marrëveshje të

Jasin Sadiku



Margëlliç dhe rrethina. Ai lexonte në gjuhën greke, mësoi të shkruante dhe të lexonte shqip, arabisht dhe më pas, përvetësoi edhe gjuhën italiane.

Jeta e tij ka qenë e komplikuar. Është arrestuar dhe arratisur nga burgu në Greqi, ka mërguar dhe jetuar në Shqipëri (Lushnjë) për disa vite dhe është rikthyer në Greqi në vitet '40.

Ka qenë jo vetëm pjesë e vorbullës dramatike dhe tragjike të historisë së Çamërisë, por edhe një individualitet me ndikim në këtë histori, sidomos për rajonin e Prevezës dhe të krahinës së Margëlliçit ku ka lindur, punuar dhe luftuar për shumë kohë për çështjen çame.

Situata në të cilën vepronin atdhetarët e Margëlliçit, ishte shumë e rrezikshme. Në atë kohë, ndaj popullsisë shqiptare në Çamëri, përgatiteshin lloj-lloj prapaskenash dhe manipulimesh.

Në rrjedhën e këtyre veprimeve antishqiptare nuk ishin përfshirë vetëm zyrtarët grekë të rangjeve të ndryshme, por edhe ndonjë përfaqësues i dërguar nga Lidhja e Kombeve, siç ishte rasti i kryetarit të Komisionit

Mikst, z. Ekstrand, i cili megjithëse i dërguar në Greqi si përfaqësues i Lidhjes së Kombeve me një misionin e rëndësishëm, për të mos lejuar asnjë shkelje dhe abuzim në shkëmbim të popullsisë greko-turke, kishte dalë hapur në mbështetje të platformës politike të Greqisë, duke mbyllur sytë ndaj veprimeve të dhunshme që kryheshin kundrejt shqiptarëve në Çamëri.

Në fillim të marsit të vitit 1925, në zyrën e Ekstrandit pretendohet se kishte mbërritur një telegram, ku hamendësohej se ishte nënshkruar nga 700 familje myslimane të zonës së Margëlliçit, të cilat “me vullnetin e tyre të lirë”, shprehnin dëshirën të përfshiheshin në këmbim.

Këtë parashtrësë të rreme, z. Ekstrand e kishte marrë në konsideratë, pa marrë asnjë kontakt me nënshkruesit e telegramit dhe ia kishte raportuar Lidhjes së Kombeve menjëherë si të mirëqenë, duke pritur transportin e çamëve drejt Turqisë.

Z. Bratly, nënkryetari i Komisionit Mikst, krejt rastësisht, duke bërë një vizitë në

Jasin Sadiku lindi në Margëlliç të Çamërisë, në vitin 1888 dhe u nda nga jeta në vitin 1942. Ai ishte një prej patriotëve dhe aktivistëve më të njohur në mbrojtjen e çështjes çame.

I ati i tij, Serveti, ishte hoxhë dhe në të gjithë kazanë njihej me emrin Mulla Serveti. Kishte shumë fëmijë dhe përpiquej të gjente mënyrën për t'i shkolluar, por shkollimi i fëmijëve myslimanë shqiptarë në Çamëri ishte tepër i vështirë sepse nuk kishte asnjë shkollë në gjuhën shqipe, por vetëm në gjuhën greke.

Megjithatë, në rininë e tij, Jasin Sadiku shquhej për vullnet të fortë dhe zgjuarsiri. Si autodidakt, lexonte shumë libra duke përfutur një kulturë të gjerë që e bëri me emër në

Margëlliç, Mazarrek dhe në fshatin Vrastov, mësoi se për nënshkrimet që ishin vënë në telegram, çamët nuk ishin në dijeni.

Mid'hat Frashëri, në atë kohë, Ministër Fuqiplotë i Shqipërisë në Athinë, nëpërmjet raportit që i dërgonte ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Tiranë, më 21 mars të vitit 1925, informonte për detajet dhe bisedimet e takimit të zhvilluar nga Jasin Sadiku me Bratly-n.

Sipas raportit të Mid'hat Frashërit, Jasin Sadiku, gjatë dialogut të zhvilluar me z. Bratly, i dëshpëruar, i ka numëruar atij të gjitha vuajtjet e çamëve, ndërsa fjalët e tij hynin në procesverbal.

Prefekti i Prevezës dhe bashkëpunëtorët e tij, kur nuk gjenin terren dhe mbështetje tek paria e kazasë së Margëlliçit, vinin në zbatim arrestimet dhe burgimet e figurave çame, me qëllim që të ngjallnin terror dhe frikë në masën çame.

Sa më të ashpra bëheshin presionet e qeveritarëve grekë ndaj shqiptarëve në Çamëri, aq më e vendosur bëhej qëndresa

çame, pa marrë parasysh rreziqet që u kanoseshin.

Kuptohet se në këtë situatë të vështirë, Jasin Sadiku dhe shumë nga bashkëqytetarët e tij, si Ahmet Aga Kasemi, Ibrahim Rojba, Haxhi Ibrahim, Mustafa Bejo, Isuf Haxhi Mahmuti, Ibrahim Mullahu etj., që kishin hyrë e dalë shpesh në burgjet greke, të akuzuar për ndjenja kombëtare shqiptare, nuk e kishin të lehtë të vepronin se ishin nën një mbikëqyrje të fortë nga Korofillaqia Greke.

Megjithatë, në Margëlliç, dita-ditës, shtoheshin radhët e veprimtarëve çamë me ide e veprime patriotike, që manifestonin rezistencën kundër spastrimit etnik të çamëve.

Hamendësimeve të grekëve duke i akuzuar çamët si “vrasës”, “grabitës”, “plaçkitës” e “bashkëpunëtorë me pushtuesit nazifashistë”, nuk u shpëtoi as Jasin Sadiku.

Kjo shprehet edhe në raportin që Nënkomanda e Korofillaqisë së Pargës i dërgonte Komandës së Lartë të Korofillaqisë së Epirit në Janinë, më 21 korrik të vitit 1942.

Në këtë raport të gjatë,

ndër të tjera, Jasin Sadiku ishte akuzuar për grabitje dhe tortura kundrejt kundërshtarëve të tij të krishterë. Referuar arkivave, del qartë se këto akuzat kanë qenë të pabaza.

Jasin Sadiku është vrarë më 6 dhjetor të vitit 1942. Vrasja e tij pati ndikim të madh jo vetëm në qarqet e njohura të kohës, por edhe për çështjen e popullsisë çame në tërësi sepse roli dhe ndikimi i tij në përpjekjet për mbijetesën e popullsisë çame ka qenë i madh, qysh nga mbrojtja e trojeve dhe të drejtave të tyre përballë dhunës shtetërore, deri tek kalvari i shpërnguljes së dhunshme.

Kombi gjen vetveten, Çamëria dhe Kosova

Instituti i Studimeve për Çamërinë ka nxjerrë në botim një tjetër libër të vlefshëm për bibliotekën e të gjithë të apasionuarve pas dokumenteve historike. Libri, me autor Agron Alibalin, titullohet “Kushtetuta, Evropa dhe minoriteti çam”. Shkrimet e përzgjedhura për botimin e këtij libri, autori i ka grupuar në katër kapituj: 1) Për Kushtetutën, 2) Për të drejtat e pakicave, 3) E drejta e zgjedhjeve dhe OSBE-ja, 4) BE-ja dhe Shqipëria.

Ndryshimet në Kushtetutë dhe kryesisht regjistrimi i popullsisë, kanë sjellë në vëmendje të drejtat që duhet të kenë pakicat dhe abuzimet që bëhen në emër të tyre. Ngulmimi i OSBE-së për reformë të re zgjedhore, integrimi në Evropë dhe standardet që duhen përmbushur për të realizuar qëllimin, janë synimet më madhore, si të qeverisë ashtu edhe të opozitës. Këto janë disa nga çështjet që autori ka trajtuar në këtë libër me karakter juridik, duke bërë analizimin e dokumenteve, situatave dhe ngjarjeve që lidhen ngushtë me të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare. Edhe pse shkrimet kanë karakter juridik dhe analitik, janë të

shkruara në mënyrë shumë të thjeshtë dhe të kuptueshme për këdo. Pavarësisht datës që mbajnë apo përsëritjeve të pashmangshme të ideve kur flitet për tema të tilla të ngjashme, temat vijojnë ende të jenë bashkëkohore, duke të kujtuar realitetin aktual të Shqipërisë.

Midis të tjerash, në kapitullin e dytë, Agron Alibali i ka kushtuar një vëmendje të veçantë çështjes çame, aspektit historik, juridik, si



edhe aktualitetit dhe miratimit të rezolutës. Autori e ka nisur analizën e vet për këtë çështje, me këto tematika: përpjekjet e para të çamëve për drejtësi, faktorët që kanë sjellë pengesa për realizimin e saj, e drejta e riatdhesimit, roli i BE-së mbi këtë çështje, roli i Greqisë dhe qeverisë shqiptare, si edhe dëshmia e Pukëvilut. Më tej, libri vijon me reflektimin për 65 vitet

e gjenocidit çam, por edhe me shqyrtimin e rolit të misionëve ushtarakë britanikë gjatë luftës në Shqipërinë e Poshtme. Analizën e kësaj teme, autori e ka përfunduar me evidentimin e çështjes së rezolutës çame, ku pas pasqyrimin të domethënies dhe rëndësisë së rezolutës, Agron Alibali ka vijuar me arritjet dhe mangësitë që kanë sjellë zvarritjen e kësaj çështjeje, por edhe me mundësinë që kjo rezolutë të

jetë miratuar qysh në vitin 2004. Në këtë botim, të bie në sy përgatitja e dukshme e autorit përpara analizës së problemeve dhe propozimeve për rrugëzgjdhjen e tyre. Përballja e tij me botën profesionale dhe akademike, si në Shqipëri, ashtu edhe në SHBA, i ka dhënë

atij besimin që të shprehë hapur dhe të argumentojë mendimin, qoftë ai në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me ekspertët e fushës, sidomos ata të huaj. Ky respekt për veten dhe vlerat e ardhura si pasojë e punës dhe përgatitjes, kanë bërë të mundur realizimin e këtij libri të vlefshëm në hartimin, zbatimin, mbrojtjen e politikave, dokumenteve përkatëse dhe synimeve kombëtare.

Aktivitetet e vitit

Këtë vit, Instituti i Studimeve për Çamërinë, nëpërmjet organizimit të veprimtarive të ndryshme, ka ndihmuar më shumë se kurrë për çështjen çame. Aktivitetet e shumta dhe të shumëllojshme të institutit, kushtuar kësaj çështjeje, me synim për të njohur, por edhe për të ndihmuar në zgjidhjen e saj, kanë nisur qysh herët, megjithatë, këtë vit, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve kulturore, konferencave të shumta ku janë trajtuar tematika të rëndësishme, promovimeve dhe botimeve të librave të gjinive dhe subjekteve të ndryshme të profesorëve më të mirë shqiptarë dhe të huaj, vërehet dobishmëria dhe serioziteti i institutit, në ndihmë të çështjes çame.

Përsa i përket promovimeve dhe botimeve të realizuara nga Instituti i Studimeve për Çamërinë, këtë vit, mund të veçojmë librin e Dr. Irakli Koçollarit, studiuesit që prej vitesh është marrë me historinë e Ali Pashë Tepelenës. Profesor Koçollari, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve për Çamërinë, i ka dhuruar lexuesit shqiptar një botim mbi marrëdhëniet diplomatike mes Britanisë dhe Ali Pashës. Pas një pune të gjatë në arkivat britanike, në librin "Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike", autori ka nxjerrë në pah një sërë dokumentesh sekrete të viteve 1807-1811, dokumente të cilat hedhin dritë

mbi një projekt të Ali Pashës, për një Shqipëri të madhe.

Duke vijuar nën valët e botimeve, Instituti i Studimeve për Çamërinë ka bërë të mundur realizimin e një prej librave më të rëndësishëm të botuar për çështjen çame, "The Cham Albanians of Greece – A Documentary Story", i përgatitur nga Robert Elsie dhe Bejtullah Destani, botim i cili u promovua në prill të këtij viti në klubin e njohur Traveller's Club në Pall Mall të Londrës. Libri, që shpall os tragjedinë çame, është përgjigje e qartë dhe për mbarë botën, përbën një fakt për krimet e Greqisë ndaj shqiptarëve të Çamërisë. Kjo tragjedi, është dokumentuar në mënyrë të shkëlqyer në këtë libër, ndër më të rëndësishmit të historisë së Çamërisë.

Në përkujtim të gjenocidit të ushtruar ndaj popullsisë shqiptare të krahinës së Çamërisë dhe të të gjitha viktimave që humbën jetën në atë eksod të dhimbshëm të datës 27 qershor të vitit 1944, "Instituti i Studimeve për Çamërinë", këtë vit organizoi takimin e radhës, me profesorë të mirënjohur dhe patriotë çam. Gjatë këtij takimi, u prezantua një nga librat më të fundit të botuar prej Institutit të Studimeve për Çamërinë, "Çamëria, tokat e çliruara shqiptare, II" të autorit italian Donatto Martuci, kushtuar tragjedisë dhe çështjes

çame, tashmë i përkthyer në gjuhën shqipe nga studiuesja Anila Omari. Libri, i shoqëruar me dokumenta arkivore dhe citime shumë interesante të studiuesve të ndryshëm, përbën një tjetër pasuri të shtuar në bibliotekën e librave me tematikë çështjen çame, të botuar nga "Instituti i Studimeve për Çamërinë".

Libri më i ri, i titulluar "Mid'hat Frashëri, ministër fuqiplotë. Athinë (1923-1926)", i përgatitur nga profesorët Luan Malltezi dhe Sherif Delvina, është botimi më i fundit që i serviret lexuesve shqiptarë.

Ky botim hedh dritë mbi punën dhe përpjekjet e ish-ambasadorit tonë në Greqi në periudhën e eksodit çam, në vitet 1923-1926. Botimi, i ndihmuar nga Instituti i Studimeve për Çamërinë, doli në dritë pas shumë studimesh të materialeve në arkivat e shtetit dhe ato greke, të shkruara me dorë nga Mid'hat Frashëri, me qëllim mbrojtjen me përkushtim të lartë kombëtar të çështjes çame. Promovimi i këtij libri u bë në në ambientet e Muzeut Kombëtar ku të pranishëm ishin përfaqësues nga bota e artit, politikës dhe gazetarisë.

Për bibliotekën e të gjithë të apasionuarve pas dokumenteve historike, nuk mund të lihet pa u përmendur edhe libri me autor Agron Alibalin që titullohet "Kushtetuta, Evropa dhe



minoriteti çam”. Në shkrimet e përzgjedhura për botimin e këtij libri, të bie në sy përgatitja e dukshme e autorit përpara analizës së problemeve dhe propozimeve për rrugëzgjdhjen e tyre.

Në Amfiteatrin e Biblotekës Kombetare të Kosovës, më datë 21 nëntor, Instituti i Studimeve për Çamërinë, në bashkëpunim me Fakultetin e Filologjisë së Universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, organizoi promovimin e librit “Kombi gjen vetveten, Çamëria dhe Kosova” të profesor Bashkim Kuçukut. Në promovimin e këtij botimi, morën pjesë shumë profesorë të mirënjohur nga Kosova dhe Shqipëria, si ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, personalitete të letërsisë dhe artit kosovar, si edhe studentë dhe dashamirës të historisë dhe kulturës çame.

Instituti i Studimeve për

Çamërinë, nuk i ka ndalur me kaq përpjekjet për të sjellë në dritë vlerat e kulturës çame. Me një demonstrim original dhe shumë të spikatur për popullsinë çame dhe për të apasionuarit e kësaj kulture të pasur, në bashkëpunim me Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore, më datë 27 maj të këtij viti, prezantoi koncertin “Kumbimi i zemrës çame”. Vendosja në skenë e të gjithë artistëve të këtij ansambli, si edhe të ftuarit e shumtë, sollën një numër të jashtëzakonshëm pjesëmarrësish. Në këtë koncert nuk munguan këngëtarët e njohur të këngës shqiptare çame në veçanti, Enkelejda dhe Hysni Alushi, Shaban Zeneli, Irini Qirjako, si edhe vallet nën drejtimin e mjeshtrit Rexhep Çeliku. Në repertorin e këtij koncerti mbi-zotëruan këngët dhe vallet çame. Duke vijuar me aktivitetet në

dobi të çështjes çame, siç është bërë traditë nga Instituti i Studimeve për Çamërinë, edhe këtë vit, është organizuar shkolla verore, por këtë herë në Sarandë. Qëllimi i kësaj iniciative është evidentimi i çështjes çame dhe njohja e saj tek të rinjtë, të cilët, ndërsa kalojnë një ekspeditë të këndshme në shoqërinë e njëritjetrit, mësojnë më shumë rreth Çamërisë dhe kësaj çështjeje, falë tematikave të shumta gjatë leksioneve të mbajtura nga profesorë dhe studiues të ndryshëm.

Instituti i Studimeve për Çamërinë, sikurse këtë vit, do të vijojë përpjekjet e palodhshme që sjellin dobi në zgjidhjen e çështjes çame, duke promovuar dokumentat historike, kulturën dhe vlerat çame, nëpërmjet botimeve të shumta me dokumentacione të faktuara, aktivitete të ndryshme dhe tematika të spikatura gjatë zhvillimit të takimeve dhe konferencave të ndryshme.



ÇAMËRI, MOJ MARTIRE

Çamëri,
Çamëri, moj martire,
brenda meje rritesh,
si gjaku në vlime.
Je e shtrenjtë si dielli,
si drita e syve,
si uji, si ajri, si buka e fëmijëve.

Çamëri, moj martire,
Të prek nëpër ëndrra,
në makthe të athëta,
si rrugën e qumështit,
me duart nga nata.
Edhe kur syve më ikën
këtu, e hijshme, ti je,
Çamëri, moj martire,
e bukura mbi dhe!

Me rrënjë në përpjekje
perëndish dhe titanësh
që kur Teti sfidoi gjigantët
dhe mëkoi Akilin
me qumështin e vet,
fryt i Martesës me Pelidin e shkret',
zot për mbi troje,
zot përmbi det!
Nga dridhjet e gurëve
të Urës në Artë
nga Paramithi e paraëndrrës,
nga Ledheza e artë,
ku lindi Epja e Epirit,
ai, Pirro burri,
Çamëri, moj shqiponjë,
të ka hije flamuri!

Je këtu në livadhe dhe ullishta,
në anëdet dhe në bregore,
në rremat e dherave dhe drurëve,
në kupolën e kaltër engjëjlore,
në eshtra dhe varre,
në rrënoja dhe muarana,
në rrënjët e gurëve
dhe të brengave tona.

Ti nuk zhbëhesh e nuk mpakesh,
as kur tymos vetminë,
as kur skuqesh e përflakesh.
Kur çamët ikin nëpër net' të përgjakura,
kur çamët kallen dherave të përbaltura,
kur çamët shtegtojnë rruginave
të lagura,
ti je!

Je këtu,
edhe kur pleqtë rrëzë oxhakëve
pëshpëritin të përhumur mite
dhe legjenda,
edhe kur fëmijët si boracakë të brengosur
mëkohen dhimbshëm me ëndrra dhe përralla,
por ti s'zbëhesh dhe s'vritesh,
Çamëri, moj e rralla!

Eh, shtëpia ime,
pa certifikatë pronësie,
me kurora agrumesh e
skelete gërmadhash rrethuar,
sikur bërtet e lemerisur
me foshnjat në dy duar,
prej flake kapluar,
prej zjarri shkrumbuar,
prej tymit mbuluar,
prej njerëzish shkretuar,
nuk do që të zhbëhesh,
mor djep i lënduar!

Eshtrat e të vrarëve janë nën dhe,
dhe në i zhvarrofshin
lokunitë e ujqve mbi dhe,
ato kanë ushqyer me palcë
e me gjak,
përrallat, portokajtë,
ullinjtë nëpër flakë,
dhe në djegshin gjithçka,
ta bëjnë shkrumb e hi,
ti mbin si Feniksi,
Nënë Çamëri!

Nga Bardhyl Maliqi

